




Richard Dawkins dhe akrobacitë e ligjërimit të tij rreth Zotit

Description

David Berlinski



Një argument për ekzistencën e Zotit është diçka e zakonshme; një argument *kundër* ekzistencës së Tij është një ngjarje për t'u shënuar. Pikërisht një argument i tillë përbën idenë qendore të librit të Richard Dawkins, *The God Delusion* (Iluzioni Zot). Është një argument të cilit ai i mvesh rëndësinë më të skajshme: në leksione dhe kumtesa të mbajtura që nga botimi i librit, ai ka lënë të kuptohet se tanimë ky argument ka trazuar përfytyrimin e besimtarëve fetarë. Këtu ai e ka gabim! Sidoqof të,

argumenti i tij është i rëndësishëm në një aspekt të dytë. Ai është një demonstrim praktik.

Dawkins i përmbledh pikëpamjet e tij në një seri prej gjashtë pohimesh mjaft të rëndësishme, nga të cilat vetëm tre të parat janë drejtpërdrejt të lidhur me preokupimet e tij – ose të miat:

I pari pohon se universi është i pagjasë.

I dyti e pranon joshjen për të shpjeguar shfaqjen e universit nëpërmjet një projektuesi.

Dhe i treti e refuzon joshjen në fjalë mbi bazën se “hipoteza e projektuesit ngre menjëherë problemin më të madh se nga kush është projektuar projektuesi.” Një variant i këtij argumenti ka qenë i njohur prej një kohe bukur të gjatë.

“Marr guximin të pyes,” mori guximin të pyeste urtari kinez Kuo Hsiang në shekullin e tretë të erës sonë, “nëse Krijuesi ekziston apo nuk ekziston. Në qoftë se Ai nuk ekziston, si mund t’i krijojë Ai gjërat? Dhe në qoftë se Ai ekziston, atëherë (duke qenë se është vetë një nga ato gjërat), Ai është i paaftë (pa krijuar veten) që të krijojë masën e formave fizike.”

Ky argument është brilant për shkak se është i shkurtër.

I bindur se Zoti nuk ekziston, Richard Dawkins mund të kishte cituar fare mirë Kuo Hsiangun, dhe ta kishte lënë diskutimin me aq.

Por ç’është e vërteta, Dawkins e prezanton argumentin e *tij* në dy faqet e para të kapitullit të katërt të librit të tij dhe e përmbledh atë në dy faqet e fundit të po të njëjtit kapitull. Materiali i ndërmjetëm – rreth dyzet faqe – i kushtohet “zgjimit për të qenë i ndërgjegjshëm” që thuhet se ndjell përsiatja mbi përzgjedhjen natyrore. Në të gjithë këtë, Dawkins nuk ka dështuar vetëm se në shpjegimin e arsyetimit të tij, dhe mua më ngelet që të ndjek udhën e pavolitshme që fillimisht të përcaktojë qartë argumentin e tij përpara se ta rrëzojë atë.

Zona e vdekur

Si një figurë publike dhe si një personazh i vërtetë në debat, Richard Dawkins mund të gjendet në zonën e vdekur që shënjon zonën e ndërmjetme të pyetjes së një fëmije – “Kush e bëri Zotin?” – dhe asaj çka klasikisti R. R. Bolgar e ka quajtur “rrënojat karakteristike të një shkence të braktisur dhe praktikisht të harruar”. Ndonëse përshkruan retorikën, Bolgar fare mirë, me këto fjalë, mund të përshkruante edhe teologjinë. Zona është e vdekur pasi pyetjet që ajo nxit janë pa përgjigje. Kjo nuk do të thotë aspak se ato janë të parëndësishme. Pyetjet fëmijërore kanë rëndësinë e tyre, dhe në rastin e ekzistencës së Zotit, domethënia e tyre qëndron në faktin se ato vënë në dyshim një pjesë të manovrave intelektuale nëpërmjet të cilave afirmohet ekzistenca e Tij.

Dyshimi është në një masë të madhe çështje temperamentit. Ai rrallëherë inkurajohet (apo shuhet) me anë të argumentit. Për temperamente të caktuara, ekzistenca e universit është një mister; një mister që

e gërryen irritueshëm veten e njeriut. Ç'ne që është kjo drej gjëje? Ka nga ata që thonë se mendimi që universi është aty jo për ndonjë arsye të mirë u dëmton të shijuarit e jetës. Ndërkohë që merrej me shkrimësi, gjueti, administrim pronash, dhe rënie në mëkat, Lev Tolstoi shprehte mjaft shpesh ndjesi të tilla. Njëlloj si Levini në *Ana Karenina*, ai cilësohej gjerësisht si një murtajë për faktin që e bënte një gjë të tillë. Në krahun tjetër, mjaft burra e gra e marrin universin hap pas hapi, dhe në qoftë se ata kanë prirjen që të pyesin përse ekziston universi, ata lehtësisht ngelen të kënaqur me përgjigjen që fizikani (dhe laureati i çmimit Nobel) Frank Wilczek e ka dhënë si me shpërfillje: “Universi”, ka shkruar ai, “duket se është thjesht njëra nga gjërat.” Gadishmëria për t'i lënë gjërat pezull në këtë mënyrë është karakteristikë e individëve të cilët William James i ka përshkruar si “me mendje të shëndoshë” – një tjetër formë për t'i përshkruar ata si të turbullt.

Pa dyshim, nëse fizikanët mund të besojnë se universi është thjesht njëra nga gjërat, atëherë besimtarët mund të pohojnë se edhe Perëndia gjithashtu është thjesht njëri nga gjërat.

Pyetjes se përse besimtarët nuk duhet të ndalen me universin, mund t'i jepet vetëm një kundërpjetje, gjegjësisht se përse fizikanët nuk duhet të vijojnë më tutje drejt Perëndisë.

Këto pika po i përmend për të theksuar atë që tanimë duhet të jetë e vetëkuptueshme: Pyetjet që lindin në zonën e vdekur janë çështje temperamenti. Instikti fetar është universal: lind te çdo njeri – së këndejmi vjen dhe thënia e famshme amerikane se “nuk ka ateist në një anije që po mbytet”. Por fakti nëse i lejohet një instikti të vijojë më tutje drejt pohimit të sinqertë, apo nëse ai mohohet dhe flaket tutje – këto nuk janë problematika që i japin përgjigje pretendimeve të qarta të argumentit.

Kjo është njëra nga arsyet përse zona e vdekur është thjesht e vdekur.

Në qoftë se Zoti nuk e ka krijuar botën, atëherë për çfarë shërben Ai? Dhe në qoftë se Ai vërtet e ka krijuar botën, atëherë cili është shpjegimi i Tij? Pyetja e një fëmije i ka hapur rrugën dilemës së një adulti. Një Zot që është tejet i paqejf për të bërë punën e krijimit, është i destinuar që të shkasë në irelevancë, qoftë dhe sikur vetëm që kërkesa e Tij për adhurim nuk do të ishte aspak në linjë me historikun e arritjeve të tij. Por në qoftë se Zoti vërtet krijoi botën, problemi që ideja e Zotit është e projektuar që të zgjidhë rishfaqet si një problem në lidhje me vetë Zotin.

Është kjo dilemë destruktive të cilën Dawkins e quan basti Boeing 747. Përmendja e një Boeing 747 ka për qëllim që të evokojë një batutë të çastit që i atribuohet astrofizikanit Fred Hoyle. Ai tha se shfaqja spontane e jetës në tokë ka po aq të ngjarë se edhe një tornado të marrë përpara një varrezë makinash dhe rrënojat në ajër t'i ngjajnë një Boeing 747. Ndonëse ateist, Hoyle qe skeptik për teorinë evolucionit të Darvinit, kurse Dawkins është i zjarrtë në mbrojtjen që i bën asaj. Duke qenë sevarreza e makinave shpreh me një ekonomi të rrallë pikërisht gjasat që favorizojnë shfaqjen spontanetë jetës – gjasat janë çuditërisht të pagjasa praktikisht në çdo përlllogaritje – ajo ka qenë një irritim për Dawkins që kur u shfaq për herë të parë. Me ndërgjegjen e tyre të papjekur mirë, shumë njerëz kanë dalë në përfundimin se kur vjen puna tek origjina e jetës, varreza e makinave është e vetmja gjë që Darwini ka ofruar.

Por, pohon Dawkins, në qoftë se një tornado nuk mund të bëjë punën e të krijuarit të jetës, atëherë Zoti nuk mund të bëjë punën e të krijuarit të universit. Tornadoja është inadkuat për shkak se jeta është e pagjasë, dhe Zoti është inadkuat për po të njëjtën arsye. Kjo kundërgoditje e ka bindur Dawkins-in se ai ka ndërmarrë një manovër intelektuale stil xhudo në pasojë dhe shkatërrimtare në rrjedhojat e saj. Basti 747, shkruan Dawkins, “shkon deri aty sa vërteton që Zoti *nuk* ekziston” (kursivet janë të miat). Vdekjen e Fred Hoyle përpara se ai të mund të çmonte përmasën e disfatës së tij Dawkins pa dyshim e konsideron si një përshfaqje të papërgjegjshmërisë tekanjoze.

Ndonëse Dawkins shkruan me një siguri në patrazuar në vetvete në lidhje me atë që ai ka për synim të bëjë – që është ta flakë në plehra Hyjninë – dhe më pas, mbasi e ka flakur tutje, shkruan sërish në lidhje me atë që Ai ka bërë, ajo çka ai bën është fare pak e qartë.

Herë herë, Dawkins thekson se Zoti është irelevant për shkak se Atij i është mveshur detyra që të ndërtojë një univers që është i pagjasë. Në qoftë se universi është i pagjasë, “pa dyshim, nuk është zgjidhje që të pohohet diçka edhe më e pagjasë [se universi].” Se përse një univers i pagjasë lyp një Perëndi të pagjasë, Dawkins nuk na e thotë dhe as unë nuk e di.

Ka pasazhe të tjera në *The God Delusion* që kanë një rafinim më analitik. Në këto pasazhe, Dawkins shtrin një pseudopod drejt koncepteve të kompleksitetit dhe informacionit. Nën ndikimin e këtyre koncepteve, Dawkins shpesh shkruan se nëse Zoti Vetë nuk është kompleks, Ai është i destinuar që të jetë inadkuat për shpjegimin e kompleksitetit të universit. Të njëjtin vëzhgim ai e bën ndonjëherë edhe në terma të informacionit. Në qoftë se Dawkins është i shkujdesur në lidhje me këto koncepte deri në pikën saqë ai shfaqet i ngathët, kjo është kështu për shkak se ai beson që pavarësisht nëse argumenti i tij është i shprehur në terma të informacionit apo kompleksitetit, Zoti do të shfaqet po në të njëjtin nivel irrelevance.

Basti 747, ndonëse vështirë se mund të quhet një model i rafinuar, përçon një mbresë kaq të fortë autoriteti, aq sa shkencëtarët të cilët asnjëherë nuk kanë menduar seriozisht në lidhje me çështjet e fesë, krejt befas habiten se përse nuk u ka shkuar më parë mendja aty. Duke qenë se nuk kanë menduar kurrë për këtë, shpesh ata duken sikur, fundja fundit, vërtet kanë menduar për të. Teksa boton mendimet e tij në librin *Gene (Gjeni)* (nuk gjeti vend tjetër?!), gjeneticisti molekular i shquar Emile Zuckerkandl ka argumentuar se Hyjnia, në qoftë se Ai ekziston, do të paraqiste “diçka si një patologji të gjendjes së të qenit”. Unë kisha shpresuar shumë që mbasi t’ia fillonte me patologjinë, Zuckerkandl do të ecte më tutje drejt një forme eksituese degjenerimi, por nuk ndodh kështu; ajo çka Zuckerkandl ofron në fund – e shpikur vetë, por homeopatike – është një zgjidhje e holluar e bastit 747. Shënjestra e tij janë teoritë e projektimit inteligjent. Teksa e emërton projektuesin inteligjent si

Inteligjenca më e Lartë, ai shkruan se “në qoftë se kompleksiteti është një problem për shpjegimet natyraliste, e para që duhet të ndeshet me këtë problem është vetë Inteligjenca më e Lartë. Projektimi Inteligent, pra, nuk zgjidh asnjë problem të parashtruar nga kompleksiteti; ai thjesht e transporton origjinën e kompleksitetit nga bota e vëzhgueshme në një botë të pavëzhgueshme dhe e bën këtë origjinë që të jetë e paaksesueshme nga hulumtimi”.

Këto janë fjalë që shpërfaqin në qëndrim një sertësi deri diku teutonike, apo gjermanike. Kritikët më pak ngulmues mund të vërejnë se të gërmosh më thellë problemet derisa ato të zhduken nga pamja nuk është vetëm taktika e arsyes së shëndoshë, por është e vetmja taktikë që ka përdorim të gjerë. Kur shkencëtarët përdorin entitete të ndryshme të pavëzhgueshme – forcat universale, simetritë e mëdha, funksionet me dy diferenciale si në mekanikë, hapësirën Calabi-Yau, lidhjet ionike, apo fushat kuantike – lopata me të cilën gërmojnë duket qartë, por ajo që gërmohet nuk duket askund. Se përse fizikanët duhet të gëzojnë avantazhe inferenciale të cilat teologëve u mohohen, këtë Zuckerkandl nuk na e thotë.

Vështirësia me këto argumente – ato i japin trajtë një zhanri krejt më vete – është se ato përpiqen që të pajtojnë dy tendenca të papajtueshme në mënyrë që të imponojnë një dilemë. Në njërin krah, ekziston pretendimi se universi është i pagjasë; në krahun tjetër është pretendimi se Zoti i dha formë universit. Të konsideruara së bashku, këto pretendime formojnë një bashkim jo të natyrshëm. Probabilitetet i përkasin botës në të cilën gjërat ndodhin për shkak se ato mund të ndodhin – krijimi i përket botës në të cilën gjërat ndodhin për shkak se ato duhet të ndodhin. Ne e shpjegojmë krijimin duke përmendur krijuesit, qofshin ato hyjni apo ligjet e natyrës. Ne shpjegojmë atë që është rastësore duke përmendur rastësinë. Nuk mund t’i bëjmë të dyja. Nëse Zoti vërtet i ka dhënë formë botës, kjo nuk është e pagjasë. Në qoftë se është e pagjasë, atëherë atë nuk e ka bërë Zoti. Më e mira që ne mund të themi është se Zoti ka bërë një botë që do të ishte e pagjasë në qoftë se ajo do të ishte prodhuar nga rastësia.

Por nuk është prodhuar nga rastësia, dhe kështu Ai nuk ka bërë një botë të pagjasë.

Ky është një hap i parë shkurajues në një argument që thuhet se i afrohet të vërtetuarit se Zoti nuk ekziston.

Një Hyjni e Pagjasë

Le të themi se Dawkins ka mjaft të drejtë. Zoti është i pagjasë!

Këtë pohim e kemi në tryezë. Për t’u përtypur nga kushdo.

Çfarë vijon më pas?

Mjaft çuditërisht, pothuajse asgjë. Unë them “mjaft çuditërisht” për shkak se teza që ekzistenca e Zotit është e pagjasë është gurrthemeli i argumentit të Dawkins dhe kështu një komoditet për ateizmin e tij. Por ateistët tradicionalisht janë preokupuar jo që të nxisin dyshimet e veta me shumë zell duke i paraqitur ato në një mënyrë që i detyrohet tej mase probabilitetit. Kjo gjë – probabiliteti, dua të them –

ka famë se është i paqëndrueshëm.

Inferenca që Dawkins propozon të mbrojë ka si premisë të sajën pretendimin se Zoti është i pagjasë; konkluzioni i saj është se ka të ngjarë që Zoti nuk ekziston. Ura inferenciale e evokuar nga basti 747, në qoftë se shkon ndokund, shkon nga ajo çfarë Zoti është (Ai është i pagasë) deri tek a ekziston Ai (me sa duket, jo). Inferencat e këtij lloji janë tipikisht jo deduktive: ato nuk i japin siguri konkluzioneve të tyre. Një inferencë deduktive e çon bindjen tëposhtë. *Të gjithë njerëzit janë të vdekshëm.* Premisa Një. *Sokrati është njeri.* Premisa Dy. Dhe konkluzioni. *Sokrati është i vdekshëm.* Duke pasur parasysh këto premisa, konkluzioni është i pakontestueshëm.

Përpjekja që inferencat që varen nga gjasa të përputhen me formën deduktive përfundon në katastrofë. Një shembull? *Duke gjykuar nga ajo se si shkruan Emili, ka të ngjarë që gjuha e tij amtare të jetë gjermanishtja.* Premisa Një. *Duke gjykuar nga ajo se ku jeton Emili, ka të ngjarë që gjuha e tij amtare të jetë anglishtja.* Premisa Dy. Çfarëdo konkluzionesh që mund të nxirren nga rrethanat e prozës së Emilit dhe vendbanimit të tij, ato nuk janë deduktive. Përndryshe, rezultati do të ishte një kontradiktë, ku Emili do të ishte i pllakosur nga dy gjuhë amtare, dhe ka gjasa edhe më shumë. Mund të jetë fare mirë – supozoj unë – që konsiderata të caktuara e bëjnë ekzistencën e Zotit të pagjasë. Konsiderata të tjera mund ta bëjnë ekzistencën e tij të ngjarë. Në qoftë se të dyja konsideratat janë kontrolluese në mënyrë deduktive, rezultati është një formë e kaosit logjik. Inferenca që mbron Dawkins nuk mund të vërtetohet asgjë në lidhje me ekzistencën e Zotit, por ama as nuk mund t'i afrohet vërtetimit të diçkaje tjetër.

Më pas është shpërthimi që rezulton kur improbabiliteti dhe ekzistenca mpleksen në mënyrë të marrëzishme. Në këtë drejtim, është e habitshme që mbasi e ka shpallur të pagjasë ekzistencën e Zotit në sajë të improbabilitetit të Tij, Dawkins as edhe një herë të vetme nuk konsideron se nëpërmjet barazisë së arsytimit ai fare mirë mund të kishte dalë në konkluzionin se ekzistenca e universit është e pagjasë për shkak të improbabilitetit të saj. E pagjasa është e pagjasë, siç thonë logjicienët, duke mos shtuar në asnjë çast, sigurisht, se në qoftë se universi është i pagjasë, atëherë ekziston arsyeja më e vogël për të supozuar se ai nuk ekziston. Pavarësisht nga kjo, supozimi se universi është i pagjasë është thelbi i bastit 747. Ai është i domosdoshëm.

Fakt është se ngjarjet e pagjasa ndodhin. Ato thjesht nuk ndodhin shpesh. Një pasanik e ka po aq të vështirë që të hyjë në mbretërinë e qiellit, kujton Bibla, sa ç'e ka të vështirë që të hyjë në vrimën e gjilpërës; dhe në qoftë se ajo është aq e vështirë, supozojë që është e pagjasë. Dhe megjithatë, disa pasanikë ia dalin që të hyjnë në atë mbretëri. Nëpërmjet këtij arsytimi, unë së paku mund të pararend se në amshim do të takohem me Mbretin Faruk, ku ai, mbasi ka kaluar i shtrydhur në vrimën e gjilpërës, mund të shihet se i gëzohet sofrave qiellore. Mund të ndodhë. Sikundërse teoricienët e fizikës kuantike nuk lodhën kurrë së na përkujtuari, ajo që mund të ndodhë herët a vonë, do të ndodhë se s'bën.

Ajo çka është e vërtetë për Farukun fare mirë mund të jetë e vërtetë edhe për Hyllin.

Mbasi ka sjellë universin në ekzistencë, Ai thjesht mund të jetë i pagjasë. Kjo është thjesht një nga ato gjërat për të cilat ne nuk kemi shpjegim të mëtëjshëm.

Ky nuk është një konkluzion i cili do t'i duket shkuraues frymës që me zjarr dëshiron të njohë Perëndinë. Por në qoftë se ne nuk kemi asnjë shpjegim të mëtejshëm për ekzistencën e Hyjnisë, ne megjithatë nëpërmjet kësaj kemi një shpjegim për ekzistencën e universit. Ai shpjegim është ky:
Në fillim Perëndia krijoi qiellin dhe tokën.

Richard Dawkins on David Berlinski | manicstreetpreacher

Image not found or type unknown

Argumentet që ngrihen mbi probabilitetin, kam sugjeruar unë, janë të paqëndrueshme. Si disa njerëz që ndërhyjnë kuturu e flasin kodra mbas bregut, ato ndërhyjnë në çastet më të këqija të mundshme. Teoria e probabilitetit është në biznesin e të mveshurit të numrave ngjarjeve. Teoria supozon shprehimisht atë çka çdokush zakonisht e merr si të mirëqenë, dhe kjo është ajo se nëse ngjarjeve u mvishen probabilitete, atëherë ato janë të determinuara nëpërmjet një procesi të rastësishëm. Një Zot i pagjasë duhet të jetë, kësisoj, i pagjasë në sajë të procesit që kontrollon probabilitetin e tij. Cili proces i rastësishëm është i projektuar që të prodhojë Hyjninë si një rezultat i mundshëm? Nuk është kurrsesi e lehtë që të thuhet, që kjo është njëra nga arsyet, supozoj unë, se mbi këtë temë, Dawkins nuk thotë as edhe një gjë.

Cilidoqoftë procesi në fjalë, probabilitetet që ai shpalos varen nga mënyra në të cilën ato përshkruhen. Ngjarjet që janë të pagjasa në afat të shkurtër bëhen probable dhe madje edhe të sigurta në afat të gjatë, si në rastin kur, teksa një majmun shtyp në kompjuter krejt i vetëm – një majmun madhështor në sajë të arritjeve të ardhshme – rikrijon *Hamletin* e Shekspirit, me çdo presje në vendin e duhur dhe me shënimet përkatëse për drejtëshkrimin e duhur të fjalëve. Sigurisht, askush nuk pret që ky gjeni ta mbarojë këtë punë fët e fët, gjë që është një tjetër mënyrë për të thënë: gjithçka varet.

Një Zot i pagjasë, të cilit i mohohet aksesi në Qenie në afat të shkurtër, mund ta gjejë veten teksa kacavirret në ekzistencë në një afat të gjatë. Por mbasi ka dështuar të kontrollojë rrethanat nëpërmjet të cilave përcaktohet probabiliteti i Zotit, Dawkins gjithashtu ka lënë pa përmendur edhe se sa gjatë kanë qenë në operim ato rrethana. Ne, kësisoj, jemi të lirë të mendojmë ndonjë eksperiment kozmik infernal që përmban hedhje zarash, rrapëllima e të cilave ka për qëllim të evokojë hyjnitë, me secilin raund që dështon të evokojë Hyjninë, derisa Perëndia më në fund shfaqet, i mbushur me entuziazëm dhe i gatshëm të krijojë universin. Për aq sa i përket Zotit, fundja fundit, Ai ka të gjithë kohën në botë.

Sigurisht, gjithçka varet.

Shpjegime pa fund

Kur basti përfundimtar 747 shprehet siç e shpreh atë Dawkins, ai shpërthen dhe më pas zbehet pa prodhuar asnjë konkluzion. Por shpesh argumentet e këtij lloji bartin me vete një hije, një hije të përgatitur në një angushti për të mposhtur personazhin kryesor. Në rastin e bastit 747, hija i detyrohet meditimeve në lidhje me strukturën e shpjegimeve racionale. Kjo është një temë e rëndësishme, dhe një temë që Dawkins është i përgatitur ta mbulojë me mantelin e shkujdesjes së tij.

Një supozim i një fuqie të vetme është në veprim përgjatë gjithë argumentimit: ngjarjet e pagjasa kanë nevojë për një shpjegim. Supozimi për fuqinë merr me vete zvarrë në vazhden e tij dy supozime shtesë. I pari është ai asi i vjetër nën mëngë: Universi është i pagjasë. Dhe i dyti është bërë prej kohësh as nën mëngë: Në qoftë se Zoti krijoi universin, Ai duhet të jetë më i pagjasë se universi që Ai krijoi. Nga supozimi i fuqisë dhe supozimet e tjera ndihmëse të tij, shfaqet shpejt një regres i pafundëm, një regres në të cilin Zoti ka nevojë të shpjegohet, gjë që nga ana e saj i jep hov kërkesës për një tjetër shpjegim, dhe kështu një tjetër Zot .

Nga kjo rrjedh se nëse Perëndia krijoi universin, ka Perëndi që janë të mbledhur përgjatë mbas tij, dhe secili sosh krijoi Zotin poshtë vetes. Ose ne duhet të heqim dorë nga ai (që dikur quhej Ai) ose ne duhet të shkojmë te Zoti që vërtet i vë gjërat në lëvizje, dhe duke qenë se nga ky argument ka pafundësisht shumë sosh, secili që supozohet më i fuqishëm, dhe sigurisht më kanosës, se të Nënrenditurit e Tij, ky është një hulumtim që ose është i garantuar të dështojë ose të çojë në një ringjallje të një forme veçanërisht të zjarrtë të politeizmit.

Imagjinoni tani që t'i drejtojmë lutjet *etërve* tanë që janë në qiell, si në njërin prej atyre librave të kobshëm për fëmijë në të cilin Mrika ka tre nëna dhe Ibrahim ka nja dymbëdhjetë baballarë.

Depressive, apo jo?

Sidoqoftë, kërkesa që shpjegimet të përmendin vetëm ngjarjet që nuk janë më të pagjasa se sa ngjarjet që ato shpjegojnë është e përkorë në nivel të patolerueshëm. “Jua kam thënë shpeshherë,” i thotë Sherlock Holms, Uotsonit, “se kur eliminohet e pamundura, ajo që ngelet, sado e pagjasë, duhet të jetë jetë detyruesisht e vërteta?”

Por në qoftë se ne e shpjegojmë një ngjarje duke evokuar një ngjarje të pagjasë, nuk pason që ne jemi të shtrënguar që të mos reshtim së kacavjerruri sipër në shkallën e një regresi të pafundëm. Kur në *Stuhia e Përkryer* Sebastian Junger përshkroi një stuhi të çuditshme pranë brigjeve të Nova Skotias, ai po shpjegonte mbytjen e një anijeje në det nëpërmjet një bashkëpërputhjeje mjaft të rrallë të faktorëve meteorologjikë. Shpjegime të tilla janë të zakonshme në të gjitha shkencat dhe ato janë të zakonshme në jetën e përditshme. Në lidhje me ngjarje të tilla të rralla, gjithçka që mund të themi është se ndonjëherë ato ndodhin. Nuk lypset që të themi më shumë. Çfarë mund të themi më tepër? Fare mirë mund të jetë se Zoti është i pagjasë dhe kjo mbaron me kaq. Kur besimtarët e krishterë japin falenderime për mrekullinë e Krishtit, ata me mrekulli nënëkuptojnë *mrekulli*.

Ndonëse Richard Dawkins ka vetëm përbuzje për teologjinë, gjë që shpeshherë shkëlqen në injorancën e tij mbresëlënëse, me argumentin e tij ai e gjen e veten duke u preokupuar me një pozitë të spikatur në mesin e “rrënojave tipike të një shkence të braktisur dhe praktikisht të harruar.”

Krahas të vuajturit të paqëndrueshmërisë së improbabilitetit, Perëndia, ekzistencën e të cilit Dawkins është i përgatitur që ta sfidojë, duket çuditërisht një figurë e zbehur. Ai e ka kryer punën e krijimit. Më pas, kohën e Tij e ka shpenzuar duke vendosur kufizime të rënda seksuale mbi popullin judaik dhe, vetëm kur ka qenë absolutisht e nevojshme, ka ndërmarrë një apo dy mrekulli. Për momentin, Ai duket se është larguar nga universi duke shmangur dhimbjen e kokës. Në paraqitjet e tij të mëparshme, Ai dukej si një robot i ngathët. Pothuajse mund të pritej që të dëgjoheshin jehonat e ngadalta të rrapëllimave hyjnore. Mbi të gjitha, Ai është së tepërmi hyjni *kontingjente*. Ndonëse Ai mund të jetë këtu sot, nesër Ai mund të mos jetë. Në qoftë se ekzistenca e Tij do të ishte e garantuar, argumenti që Dawkins ka paraqitur do të dështonte pa filluar në vend se të fillonte pa dështuar.

Dhe megjithatë këto janë konsiderata të mirënjohura në historinë e mendimit teologjik. Ato përbëjnë mishin dhe shpirtin e argumentit të dytë kozmologjik të Toma Akuinit, dhe nëse Akuini i kushton vetëm disa pak fjalë, kjo ndodh për shkak se ai kërkon vetëm disa pak fjalë për të shprehur atë që lipset thënë. Çdo konceptim i një hyjnie kontingjente, argumenton Akuini, është i destinuar që të dështojë, dhe është i destinuar të dështojë pikërisht për shkak se çfarëdo që të bëjë Ai për të shpjeguar ekzistencën e universit, ekzistenca e Tij sërish do të kërkonte një shpjegim. “Rrjedhimisht, jo të gjitha qeniet janë thjesht të mundura, por duhet të ekzistojë diçka që ka ekzistencë të domosdoshme.”

Konkluzioni se një besimtar fetar do të marrë nga argumenti i Dawkins është ose se Zoti është i pagjasë ose se Ai është i *domosdoshëm*.

Ajo çka Dawkins ka përcaktuar qartë shërben kryesisht si një përkujtues: Shpjegimet kanë një fund, dhe për shkak se jemi njerëz, ato duhet të përfundojnë përpara se të kenë kënaqur çdonjërin prej nevojave tona emocionale. Por ateistët shkencorë duhet të jenë së paku të hapur ndaj mundësisë që shpjegimet shkencore, në vetë natyrën e tyre, përfundojnë përpara se të kenë kryer të gjithë punën që mund të bëjë një shpjegim. Edhe pse mund të mos e kenë lexuar *Summa Theologica* të Akuinit, fizikanët megjithatë e kanë dëgjuar melodinë e saj. Ata kanë shpresuar se do të zbulonin ligjet e ndonjë teorie finale fizike aq të fuqishme sa që ato ligje do të shpjegonin cilësinë e lëndës në të gjitha moduset e saj. “Shpresa më ekstreme për shkencën,” ka shkruar Steven Weinberg, “është se do të jemi në gjendje të gjurmojmë shpjegimin e të gjitha dukurive natyrore në ligjet finale dhe aksidencat historike.”

Kjo është shpresa më ekstreme për shkencën për ata, si Frank Wilczek, që kanë prirjen të thonë në njëfarë pike se gjërat janë pikërisht kështu. Për të tjerë, komoditeti intelektual gjendet me pak më tepër vështirësi. “Ne ndjejmë,” ka shkruar Wittgenstein-i, “se madje edhe kur të gjitha pyetjet e mundshme shkencore kanë marrë përgjigje, problematikat e jetës ngelen krejtësisht të paprekura.” Ata të cilët ndihen kështu, do të shohin, në gjurmët e Akuinit, se e vetmja inferencë e përlllogaritur për të kapërcyer

mënyrën se si gjërat janë është ajo që drejtohet karshi mënyrës së si gjërat duhet të jenë.

Ndoshta, në fund kjo do të vërtetohet se është punë matematike. Fizikani i MIT, Max Tegmark, ka argumentuar se kështu është. Fizikani Edward Witten dhe matematikani Alain Connes kanë shkruar të dy gjerë e gjatë mbi origjinën e krijimit në një strukturë matematikore pashpjegueshëm të thjeshtë, një strukturë kjo kaq e fuqishme saqë prej saj mund të derivohen edhe vetë hapësira dhe koha.

Me këto spekulime ambicioze në tryezë, ia vlen që të sjellim në kujtesë se në të lokalizuarit e origjinës së krijimit tek disa struktura fundamentale abstrakte, matematikanët po i mveshin atyre strukturave një shkallë të vullnetit të veprimit, apo agjensisë, që deri më sot ato nuk dukej se e zotëronin.

Na ka ngelur dhe një pikë e fundit. Ajo çka një njeri e refuzon si e pakëndshme duhet të matet gjithnjë përkundrejt asaj çka ai është i gatshëm ta përtypë me qejf. Ajo çka Richard Dawkins është i gatshëm të përtypë me qejf është Peizazhi dhe Parimi Antropik. Sigurisht, Peizazhi nuk i jep përgjigje pyetjes se çfarë ishte ajo çka e shkaktoi ekzistencën e peizazhit. A mundet vallë ta japë këtë përgjigje?! Dhe nëse Peizazhin nuk e shkaktoi asgjë, kjo nuk i përgjigjet aspak pyetjes se përse peizazhi është aty ku është.

Por mbasi e ka përtypur Peizazhin me një gusto kaq të paimitueshme, Dawkins pa dyshim është i obliguar që të shpjegojë se përse ai ka rezerva për Hyjninë. Fundja fundit, teologu lipset vetëm që t'i drejtohet një Zoti të vetëm që sundon mbi gjithçka dhe mbi një univers të vetëm – universin tonë. Dawkins duhet të përdorë universet pafundësisht të shumta të ngjeshura në krijim, me ligjet e natyrës që përdridhen pa takt dhe me parametrat fundamentale fizikë që ndryshojnë teksa një njeri udhëton nga njëri cep i kozmosit në tjetrin, dhe teksa e gjithë struktura gjigante është shkencërisht e pavëzhgueshme dhe e zbratur nga çdo lidhje me përvojën.

Kjo është pika që Dawkins orvatet që ta plotësojë, por me një sukses të pamjaftueshëm. “Diferenca kyçe ndërmjet hipotezës rrënjësisht ekztravagante të Zotit,” shkruan ai, “dhe hipotezës në dukje ekztravagante të multiversit, është një diferencë e improbabilitetit statistikor.”

Vërtet? Nuk e kisha menduar kështu, aq më tepër që fjalia pasuese e Dawkins duket se bie ndesh me fjalinë që ai sapo ka shkruar. “Multiversi, sado ekstravagant qoftë, është i thjeshtë,” për shkak se çdonjëri prej universeve të tij përbërës “është i thjeshtë në ligjet e tij fundamentale.”

Në qoftë se kjo është e vërtetë për çdonjërin prej atyre universeve përbërës, atëherë ajo është e vërtetë edhe për universin tonë gjithashtu. Dhe në qoftë se universi ynë është i thjeshtë në ligjet e tij fundamentale, ku qëndruaka atëherë relevanca e argumentit të Dawkins?

Gjëra të thjeshta, shpjegime të thjeshta, ligje të thjeshta, një Zot i thjeshtë.

Bon appétit

Përktheu: Arjol Guni

Date Created

29/03/2021

Author

erasmusi